

NJOFTIM STATISTIKOR
BILANCI I PAGESAVE

BILANCI I PAGESAVE¹

Përmbajtja

Llogaria korrente	2
Tregtia e mallrave	3
Tregtia e shërbimeve	3
Të ardhurat parësore	4
Të ardhurat dytësore	5
Llogaria kapitale	5
Llogaria financiare	5

Kryesore:

Në tremujorin e katërt të vitit 2024:

- Deficiti i llogarisë korrente vlerësohet në rreth 374 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë;
- Llogaria e shërbimeve vlerësohet në një balancë pozitive prej rreth 886 milionë euro, me rritje në terma vjetorë;
- Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 423 milionë euro, në rritje vjetore me 7%;
- Të ardhurat në formën e prurjeve valutore nga emigrantët shënuan 273 milionë euro;
- Stoku i rezervës valutore në fund të periudhës vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 7.0 muaj importe në mallra dhe shërbime.

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi pozitiv, në rritje të mjetëve të rezervës valutore me rreth 293 milionë euro.

Deficiti i llogarisë korrente shënon 374 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me rreth 133 milionë euro (ose 55%), në sfondin e përkeqësimit të deficitit tregtar në mallra.

Një pjesë e konsiderueshme e deficitit të llogarisë korrente i atribuohet kërkesës së lartë të brendshme për importe dhe rënies së të ardhurave nga eksportet. Ndërkohë, flukset në të ardhura dytësore janë nxitur kryesisht nga remitancat, ndërsa ato në të ardhura parësore kryesohen nga të ardhurat nga puna, si dhe flukse dalëse të kthimit nga investimet.

Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto pozitiv prej 44 milionë euro, kundrejt fluksit neto negativ prej 50 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Shkalla e ekspozimit² të ekonomisë shqiptare vlerësohet në 331 milionë euro kundrejt nivelit prej 291 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar.

Flukset hyrëse në llogarinë kapitale dhe financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) shënojnë 605 milionë euro dhe mundësojnë plotësisht mbulimin e deficitit korrent.

Në një total prej rreth 561 milionë euro (pa përfshirë mjetet e rezervës) flukset neto hyrëse në llogarinë financiare, reflektojnë zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (382 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (360 milionë euro), ndërkohë që investimet e portofolit rezultuan në flukse neto dalëse ose në zgjerim të pretendimeve të ekonomisë shqiptare jashtë, në rreth 182 milionë euro.

Rezerva valutore, në fund të dhjetorit 2024, shënon 6,264 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.0 muaj importe mesatare vjetore në mallra dhe shërbime dhe rreth 528% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.



Grafik 1. Llogaria korrente dhe flukset financiare neto (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).
Shënim: Flukset financiare neto paraqiten sipas parimit të drejtimit të investimit.

1. Të dhënat janë hartuar bazuar në metodologjinë e FMN "Manuali i Bilancit të Pagesave, Botimi i 6-të". Bilanci i Pagesave (BP) regjistron të gjitha transaksionet ekonomike të ndodhura midis njësitë rezidente dhe jorezidente, gjatë një periudhe të dhënë kohe.

2. Bilanci i llogarisë korrente së bashku me bilancin e llogarisë kapitale përcakton shkallën e ekspozimit të ekonomisë shqiptare me pjesën tjetër të botës, ndërsa llogaria financiare shpjegon si është financuar ky ekspozim.

LLOGARIA KORRENTE

Gjatë tremujorit të katërt 2024, vëlimi i përgjithshëm i transaksioneve korrente u zgjerua me rreth 6% në terma vjetorë, në nivelin 5,858 milionë euro. Deficiti i *llogarisë korrente* vlerësohet në 374 milionë euro, i zgjeruar me rreth 133 milionë euro në terma vjetorë.

Përkeqësimi i *llogarisë korrente* në masë të konsiderueshme u ndikua nga thellimi i deficitit tregtar në *mallra*. Kontribut në zbutje të deficitit korrent, në rreth 59%, dhanë zgjerimi i bilancit pozitiv në *tregtinë e shërbimeve* dhe atij të të *ardhurave dytësore* së bashku me ngushtimin e bilancit negativ të të *ardhurave parësore*.

Deficiti tregtar në mallra u thellua me rreth 325 milionë euro në terma vjetorë dhe reflekton kryesisht përkeqësimin e bilancit tregtar në grupmallrat “*makineri e pajisje mekanike dhe elektrike*”, “*metale bazë*” dhe “*produkte minerale*”, diktuar nga zgjerimi i importeve në “*makineri e pajisje mekanike dhe elektrike*” dhe tkurrja e eksporteve në “*metale bazë*”, e *produkte minerale — energji elektrike dhe lëndë djegëse*.

Në terma vjetorë, suficiti tregtar në *shërbime* u zgjerua me 19% në nivelin 886 milionë euro, ku shërbimet e udhëtimit zgjeruan ndjeshëm bilancin pozitiv (me rreth 147 milionë euro).

Të ardhurat parësore (puna dhe kapitali) rezultojnë në balancë negative prej rreth -51 milionë euro, kundrejt -86 milionë euro në të njëjtën periudhë në vitin e kaluar. Flukset neto hyrëse të të *ardhurave nga puna* janë zgjeruar me +20 milionë euro, në nivelin 165 milionë euro, ndërkohë që, të *ardhurat nga investimi* (kthimit nga kapitali) ngushtuan balancën negative me rreth 14 milionë euro në nivelin 216 milionë euro.

Gjatë periudhës, rreth 89% e shpenzimeve korrente³ kanë shkuar për financimin e importit të mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, hyrjet valutore⁴ janë siguruar kryesisht nga eksporti i shërbimeve (në masën 63%), si dhe nga eksporti i mallrave dhe transfertave të njëanshme drejt sektorit privat (sëbashku në rreth 29%).

Në tremujorin e katërt 2024, përkeqësimi i deficitit korrent është ndikuar kryesisht nga thellimi i deficitit tregtar në mallra

Llogaria korrente

në përqindje ndaj PBB

Mallra

Shërbime

Shërbime për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët

Transport

Udhëtime

Shërbime telekomunikacioni, kompjuteri dhe informacioni

Shërbime të tjera biznesi

Shërbime dhe mallra qeveritare

Shërbime të tjera

Të ardhura parësore

Të ardhura nga puna

Të ardhura nga investimet

Investime direkte

Investime portofoli

Investime të tjera

Mjetet e rezervës

Të ardhura të tjera parësore

Të ardhura dytësore

Të ardhura nga emigrantët

Të dhëna kumulative (4-mujore) për fundin e periudhës, në milionë euro							
T4 2023			T4 2024			T4 2023	T4 2024
Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Kredi	Debi	Bilanci	Bilanci
264	10,547	10,811	607	11,555	12,162	241.1	374.4
-1%	48%	49%	-2%	47%	50%		
4,540	1,836	6,376	5,593	1,679	7,272	1,221	1,546
3,358	6,572	3,214	3,876	7,410	3,534	744	886
770	771	1	662	662	1	178	164
320	713	393	427	792	365	69	65
1,838	4,173	2,335	2,292	4,992	2,700	376	523
85	198	113	119	222	102	30	36
389	535	146	469	597	129	121	123
8	45	37	11	47	58	0	4
53	135	188	82	97	179	30	21
278	771	1,050	191	959	1,150	86	51
535	571	36	624	664	40	145	165
813	191	1,004	816	284	1,100	231	216
769	60	829	789	94	883	210	218
15	53	39	16	79	64	8	6
119	17	136	137	17	154	33	29
61	61		93	93		21	25
0	9	10	1	10	9	0	0
1,197	1,368	171	1,301	1,508	206	322	337
928	928	-	1,045	1,045	-	252	273

Tabela. Ecuria e përbërësve të bilancit të pagesave (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)

³ Shpenzimet korrente përfshijnë importin e mallrave, importin e shërbimeve, daljet në të ardhurat parësore dhe daljet në të ardhurat dytësore.

⁴ Hyrjet valutore përfshijnë eksportin e mallrave, eksportin e shërbimeve, hyrjet në të ardhurat parësore dhe hyrjet në të ardhurat dytësore.




TREGTIA E MALLRAVE

Vëllimi i përgjithshëm i tregtisë në mallra u zgjerua me 5% në terma vjetorë, në nivelin 2,333 milionë euro. Tregtia në mallra përfaqëson rreth 40% të transaksioneve korrente.

Eksporti i mallrave ra me 22% në terma vjetorë, në nivelin 393 milionë euro. Rënie e konsiderueshme është vërejtur në eksportet e “metaleve bazë” dhe e produkte minerale – energji elektrike dhe lëndë djegëse. Kjo rënie është kryesisht pasojë e zhvillimeve globale të çmimeve për lëndët djegëse të papërpunuara dhe energji elektrike.

Importi i mallrave u zgjerua me 12% në terma vjetorë në nivelin 1,940 milionë euro. Rritjen më të madhe e shënuan importet në grupmallrat “makineri e pajisje mekanike dhe elektrike”, duke reflektuar rritjen e përgjithshme të konsumit të familjeve, aktivitetit turistik dhe zhvillimeve në sektorin e ndërtimit.

Deficiti tregtar në mallra shënon 1,546 milionë euro, i thelluar në terma vjetorë me 27%.



Grafik 2. Ecuria e tregtisë në mallra (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

TREGTIA E SHËRBIMEVE

Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve u mbyll me një balancë pozitive, prej rreth 886 milionë euro, e zgjeruar në terma vjetorë me rreth 19%. Kjo ecuri u diktua nga zgjerimi i të ardhurave neto të udhëtimeve, në reflektim të konsiderueshëm të numrit të udhëtarëve të huaj në Shqipëri.

Shërbimet e udhëtimit kanë zgjeruar balancën pozitive në +523 milionë euro, kundrejt nivelit +376 milionë euro në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në terma vjetorë, të ardhurat dhe shpenzimet e kësaj kategorie u rritën respektivisht me rreth 19% dhe 5%. Rritja e numrit të udhëtarëve përbën faktorin përcaktues për këtë ecuri. Në të njëjtën kohë, shpenzimi ditor dhe kohëqëndrimi për udhëtar janë vlerësuar në rritje.

Për tremujorin e katërt 2024, eksporti i shërbimeve të udhëtimit i ka siguruar ekonomisë vendase rreth 1,1 miliardë euro. Nga ana tjetër, udhëtarët rezidentë (shqiptarë dhe të huaj) kanë shpenzuar në udhëtimet e tyre jashtë vendit 612 milionë euro.

Shërbimet e udhëtimit gjenerojnë respektivisht 66% të flukseve valutore në hyrje dhe rreth 74% të shpenzimeve të kategorisë së shërbimeve.

Thellimi i deficitit tregtar në mallra reflektoi zgjerimin e kërkesës së brendshme për importe në makineri e pajisje mekanike e elektrike, sëbashku me zhvillimet në çmimet e tregjeve të lëndëve të para



Bilanci pozitiv i shërbimeve për përpunim të inputeve fizike të zotëruara nga të tjerët⁵ u vlerësua në 164 milionë euro nga 178 milionë euro në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Kjo kategori shërbimesh regjistron vlerën e shtuar neto nga shërbimi, që ekonomia shqiptare i ofron partnerëve të huaj (jorezidentëve) për përpunimin e mallrave të zotëruara (ose me lëndë të parë) prej këtyre të fundit.

Shërbime të tjera biznesi rezultuan me bilanc pozitiv prej 123 milionë euro, në rritje vjetore prej 2%. Për tremujorin e katërt të vitit, flukset valutore hyrëse për ekonominë shqiptarë nën këtë kategori shërbimi, shënuan rreth 159 milionë euro.

TË ARDHURAT PARËSORE


Llogaria e të ardhurave parësore (puna dhe kapitali) u mbyll me bilanc negativ prej -51 milionë euro nga -86 milionë euro në të njëjtën periudhë një vit më parë. Kjo ecure u ndikua kryesisht nga zgjerimi i të hyrave neto nga puna (kompensimi i punonjësve).

Të ardhurat neto nga puna, të cilat kryesojnë flukset hyrëse të të ardhurave parësore, rezultuan në një fluks neto pozitiv prej 165 milionë euro ose 14% më shumë se në të njëjtën periudhë një vit më parë. Rritja i dedikohet në masën më të madhe rritjes së numrit të punonjësve sezonalë dhe kufitarë jashtë vendit.

Të ardhurat neto nga investimet ngushtuan balancën negative, në nivelin -216 milionë euro nga -231 milionë euro, në tremujorin e katërt të 2023. Flukset valutore neto nga investimi, në masë më të madhe, janë në formën e flukseve dalëse të "fitimit të riinvestuar"⁶. Këto të fundit, ranë lehtësisht në 224.9 milionë euro nga 226.2 milionë euro në një vit më parë.

Ndërkohë, pagesat e interesave për huatë shënuan 49 milionë euro nga 63 milionë një vit më parë.

Bilanci negativ i të ardhurave parësore është përmirësuar si pasojë e zgjerimit të të ardhurave nga puna



Grafik 3. Ecuria e të ardhurave parësore nga investimet (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

⁵ Këtu përfshihet vëllimi i transaksioneve të kryera nga industria e përpunimit me lëndë të parë të huaj në vend.

⁶ Konform standardit metodologjik—parimit të regjistrimit të dyfishtë të transaksionit, zëri "fitim i riinvestuar", si komponent i investimeve direkte në llogarinë financiare, duhet të regjistrohet edhe në llogarinë e të ardhurave parësore nga investimet. Ky regjistrim kryhet në masë të njëjtë, por në kahe të kundërta.




TË ARDHURAT DYTËSORE

Të ardhurat dytësore u vlerësuan në 337 milionë euro. Rreth 81% e të ardhurave dytësore përfaqësohet nga “të ardhurat nga emigrantët”.

Prurjet valutore të emigrantëve shënuan rreth 273 milionë euro, në rritje vjetore (8%).

Gjatë periudhës është vërejtur zgjerim jo vetëm në volumnin e dërgesave përmes kanaleve formale (sistem bankar), por edhe prurjeve në cash.



Grafik 4. Ecuria e të ardhurave dytësore dhe të ardhurat nga emigrantët (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

LLOGARIA KAPITALE

Llogaria kapitale u mbyll me një fluks neto pozitiv prej 44 milionë euro, kundrejt fluksit neto negativ 50 milionë euro një vit më parë. Kjo ecuri është diktuar kryesisht nga flukse të larta hyrëse drejt sektorit privat, së bashku me grante të huaja për qeverinë shqiptare për mbështetje buxhetore.

LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare (pa përfshirë mjetet e rezervës) rezultoi në fluks neto hyrës prej rreth 561 milionë euro, krahasimisht me fluksin hyrës prej 357 milionë euro, të regjistruara në të njëjtën periudhë në 2023.

Flukset hyrëse (neto) në llogarinë financiare, reflektojnë zgjerimin e detyrimeve neto në formën e investimeve direkte (382 milionë euro) dhe të investimeve të tjera (360 milionë euro), ndërkohë që investimet e portofolit rezultuan në flukse neto dalëse ose në zgjerim të pretendimeve të ekonomisë shqiptare jashtë, në rreth 182 milionë euro.

Fluksi hyrës nga investimet e huaja direkte shënon 423 milionë euro, i zgjeruar në terma vjetorë me 7%. Injektimi me kapital të ri dhe riinvestimi shënuan 418 milionë euro, pa lëvizje të konsiderueshme (ose +0.2%) nga niveli i regjistruar në një vit më parë.


Më tej, marrëdhëniet e borxhit mes kompanive të lidhura nën një marrëdhënie të investimit direkt, rezultuan me një fluks hyrës, prej 5 milionë euro (rritje e detyrimeve si instrument borxhi mes kompanive të lidhura).

Për tremujorin e katërt të vitit 2024, prurjet valutore nga emigrantët vlerësohen në rreth 273 milionë euro




Gjatë tremujorit të katërt 2024, flukset valutore hyrëse në formën e *investimeve të huaja direkte* ishin të përqendruara kryesisht në pasuri të paluajtshme (në masën 25%), sektorin e ndërmjetësimit financiar (në masën 19%), hidrokarbureve (në masën 13%), energjitikës (në masën 7%), si dhe komunikacionit (në masën 6%).

Në të njëjtën kohë, zotërimet tona jashtë - mjetet financiare në formën e *investimeve direkte jashtë* vlerësohen në rreth 41 milionë euro, në rënie me rreth 24%.



Grafik 5. Llogaria financiare dhe flukset neto sipas kategorive përbërëse (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)



Grafik 6. Ecuria e fluksit të investimeve direkte - mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve)


Investimet e portofolit rezultuan në një fluks neto dalës prej 182 milionë euro. Ecuria është kryesisht rrjedhojë e zgjerimit të zotërimeve jashtë të sektorit të korporatave depozituese në letra me vlerë të borxhit (me 147 milionë euro). Në të njëjtën kohë, ka vijuar rënia e detyrimeve ndaj jorezidentëve, pasojë e tkurrjes së ekspozimit të letrave me vlerë të borxhit me 36 milionë euro (rezultat i rritjes së pjesëmarrjes së bankave rezidente në eurobondin e Qeverisë së Përgjithshme).

Llogaria *investimet e tjera* u mbyll në një fluks neto hyrës prej 360 milionë euro. Sërish zhvillimi i atribuohet sektorit të korporatave depozituese në kuadër të strategjisë së investimit, që ka rezultuar në zhvendosje të zotërimeve nga “monedha dhe depozita” (rreth 284 milionë euro) në letra me vlerë të borxhit (shih paragrafin më sipër).

Në kahun e detyrimeve, për sektorin e korporatave depozituese është zgjeruar detyrimi në monedha e depozita ndërbankare me rreth 58 milionë euro. Në të njëjtën kohë, detyrimet në formën e huasë të Qeverisë së Përgjithshme kanë rezultuar në zgjerim të fluksit neto me rreth 19 milionë euro.

Investimet e huaja direkte u vlerësuan në 423 milionë euro, në rritje rreth 7% në terma vjetorë





Grafik 7. Ecuria e fluksit të investimeve të portofolit dhe investimeve të tjera – mjete dhe detyrime (shuma rrëshkitëse e katër tremujorëve).

Gjatë tremujorit të katërt 2024, *mjetet e rezervës* u zgjeruan me 293 milionë euro, ndikuar kryesisht nga blerjet e valutës në ankand për qëllime të rritjes së rezervës valutore dhe ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun valutator.

Në fund të periudhës, *rezerva valutore* shënon 6,264 milionë euro, mjaftueshëm për mbulimin e 7.0 muaj importe mesatare vjetore në *mallra dhe shërbime*.

*Rezerva valutore
vlerësohet mjaftueshëm
për mbulimin e 7.0
muaj importe mesatare
vjetore në mallra e
shërbime*



**DEPARTAMENTI I
STATISTIKAVE
FINANCIARE**

Selia Qendrore Nr. 1 e Bankës së
Shqipërisë, Sheshi "Skënderbej", Nr.1,
Tiranë

Tel: +355 4 241 93 01
+355 4 241 93 02
+355 4 241 93 03
+355 4 241 94 09
+355 4 241 94 10
+355 4 241 94 11

Fax: +355 4 241 94 08
Email: statistics@bankofalbania.org



Shënime:

Banka e Shqipërisë rezervon të drejtën për të bërë rishikimin e statistikave të publikuara. Në rastin e rishikimeve që sjellin ndryshime të treguesve, Banka e Shqipërisë njihet përdoruesit me faktorët e rishikimit dhe ndikimin përkatës.

Gjatë periudhës kanë ndodhur ndryshime në bilancin e pagesave, si pasojë e rishikimeve, pasojë e plotësimit të informacionit me të dhëna nga njësitë raportuese.

Është rishikuar seria kohore T1/2024-T3/2024, bazuar në politikën e rishikimit të Bankës së Shqipërisë.

Për më shumë informacion mbi të dhënat e bilancit të pagesave referojuni linkut të mëposhtëm:

https://www.bankofalbania.org/Statistikat/Statistikat_e_Sektorit_te_Jashtem/Bilanci_i_Pagesave/Te_dhenat_kryesore_per_Bilancin_e_Pagesave.html